



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

R R E G U L L O R E
PËR DHËNIEN E DEKORATAVE TË OSK-SË

Prishtinë, prill 2022

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TE KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, dhe Nenin 20 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OSK-së, në mbledhjen e datës 06.04.20221, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR

DHENIEN E DEKORATAVE TË OSK-SË

I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet procedura dhe mënyra e dhënies së dekoratave të Odës së Stomatologëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Oda).

Neni 2

Fushëveprimi

Dekoratat e Odës janë mirënjohjet e dhëna nga Oda për anëtarët e saj të shquar, si dhe për individë të tjerë, institucione, organizata dhe persona juridik për kontribut të veçantë ndaj Odës dhe për promovimin e saj në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit si dhe për promovimin dhe ruajtjen e vlerave më të larta të profesionit të stomatologut dhe veprimtarisë stomatologjike në përgjithësi.

Neni 3 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

Dekorata — Vlerësimi më i lartë i OSK-së për anëtarët kontribut dhënës në fushën e Stomatologjisë.

Çmimi vjetor — që jepen për anëtarët që kanë të arritura shkencore në fushën e stomatologjisë.

Mirënjohje — e cila u jepet anëtareve të Odës dhe individëve të tjerë, institucioneve, organizatave, shoqatave e dhe personave juridikë për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës.

Revokim i dekoratës - heqja e së drejtës dikujt, për bartjen e Dekoratës së dhënë nga Oda

Këshilli Drejtue – Organ i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Komisioni për Dhënien e Dekoratave - Organ i Odës-së i cili është përgjegjës për shqyrtimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave për dhënien e dekoratave.

Buxheti — Vijë buxhetore e ndarë për dekorata dhe çmime.

II. DEKORATAT E ODËS

Neni 4

1. Oda e Stomatologëve të Kosovës do të ketë 4 lloje të dekoratave, si në vijim:

1.1. Dekorata “Nderi i Stomatologjisë Kosovare”

1.2. Dekorata për Arritje shkencore;

1.3. Mirënjohja e Odës së Stomatologëve të Kosovës;

1.4. Çmimi vjetor i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Neni 5

Pamja vizuale (dizajnimi) i llojeve të dekorata e të dhëna nga OSK-ja sipas Nenit 3 të kësaj Rregulloreje përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 6

E njëjta dekoratë nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtit person.

Neni 7

Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërblim në të holla, sipas kriterëve që do të caktojë Këshilli Drejtues i Odës.

DEKORATA “NDERI I STOMATOLOGJISË KOSOVARE”

Neni 8

1. Dekorata “Nderi i Stomatologjisë Kosovare” i jepet stomatologut në rastet kur:
 - 1.1 për veprat dhe emrin e tyre nderojnë komunitetin e stomatologëve brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.2 të ketë veprimtari të shquar dhe cilësore në fushën e stomatologjisë në vijueshmëri;
 - 1.3 të ketë veprimtari ose vepra të njohura profesionale dhe shkencore si brenda dhe në mënyrë të veçantë jashtë territorit të Republikës së Kosovës;
 - 1.4 të ketë kontribut të shquar dhe merita të veçanta në fushën e stomatologjisë
2. Dekorata “Nderi i Stomatologjisë Kosovare” mund të jepet edhe post-mortem.

DEKORATA PËR ARRITJE SHKENCORE

Neni 9

Dekorata për arritje shkencore e Odës së Stomatologëve të Kosovës u jepet anëtareve të Odës të cilët kanë të arritura të vërtetuara në fushën e stomatologjisë, me kontributin e shprehur në nivel evropian dhe botëror.

MIRËNJOHJA E ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS

Neni 10

1. Mirënjohja e Odës së Stomatologëve të Kosovës u jepet anëtarëve të Odës dhe individëve të tjetër, institucioneve, organizatave, shoqatave dhe personave juridik për dhënien e kontributit të çmueshëm për Odën, për dhënien e kontributit në promovimin e vlerave të Odës, programeve, projekte dhe qëllimeve thelbësore të Odës në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit.
2. Mirënjohja e Odës së Stomatologëve të Kosovës i jepet një anëtar të Odës pas vdekjes si shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për anëtarësi të përgjegjshme shumëvjeçare dhe kontribut në punën e Odës së Stomatologëve të Kosovës si dhe në dhënien e shërbimeve stomatologjike për popullatën e Kosovës.

ÇMIMI VJETOR I ODËS SË STOMATOLGËVE TE KOSOVËS

Neni 11

1. Çmimi vjetor i Odës së Stomatologëve të Kosovës ndahen mbi këto baza:
 - 1.1 Anëtarit të Odës i cili ka publikuar punimin e vet original shkencor, në revistat shkencore me faktorin e indeksuar të ndikimit (*Impact factor*) së paku 1 në bazën e të dhënve *Web of Science* apo *Scopus*.
 - 1.2 Nëse anëtar i Odës ka publikuar disa punime në revistat përkatëse shkencore në vitin kalendarik, atëherë mblidhen faktorët e tij të ndikimit dhe arrihet e ashtuquajtura shumë e faktorëve të ndikimit. Nëse disa anëtarë të Odës kanë të njëjtën shumë të faktorëve ndikues të punimeve shkencore, çmimi vjetor i Odës së Stomatologëve të Kosovës do t'i jepet anëtarit të Odës i cili është autori i parë në më shumë punime shkencore të këtilla.
 - 1.3 Anëtarit të Odes i cili në mënyrë të veçantë, me veprimtari të jashtëzakonshme ka mbrojtur të drejtat e stomatologëve dhe ka kontribuar në promovimin e interesave të stomatologjisë kosovare.
2. Kushtet tjera dhe procedurat për mbështetje financiare përcaktohen me konkurs, të cilin e shpallë Këshilli Drejtues i Odës.

3. Këshilli Drejtues i Odës vendos mbi vlerën monetare si dhe pamjen e mirënjohjes me shkrim të çmimit vjetor të Odës.
4. Gjatë një viti mund të jepet vetëm një çmim vjetor i Odës së Stomatologëve të Kosovës mbi secilën bazë të cekur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 12

Dhënia e propozimit për dekorata

1. Propozimi për dhënien e dekoratave (Dekorata Nderi i Stomatologut; Dekorata për Arritje shkencore dhe Mirënjohja e Odës së Stomatologëve të Kosovës) mund t'i dorëzohet Këshillit Drejtues të Odës drejtpërdrejtë nga:
 - 1.1. Kryetari i Odës;
 - 1.2. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës;
 - 1.3. Anëtarët e Kuvendit të Odës.
2. Propozimi për dekoratë është i plotë nëse shoqërohet me arsyetim përkatës ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit me biografi të personit të propozuar.
3. Anëtarët e Odës nuk mund ta propozojnë vetveten për dhënien e dekoratës.
4. Miratimi i propozimeve për dekorata është e drejtë e Këshilli Drejtues të Odës, i cili vlerëson propozimin, e miraton ose nuk e miraton, vendos për të dhënë dekoratë tjetër nga ajo që është propozuar ose e riformulon arsyetimin.

Neni 13

Mënyra e dhënës së dekoratave

1. Dhënia e dekoratave vendoset nga Këshilli Drejtues i Odës në bazë të propozimit përfundimtar të Komisionit, përveç Dekoratës "Nderi i Stomatologjisë Kosovare", për të cilën është i nevojshëm miratimi paraprak i Kryetarit të Odës.
2. Për kohën, vendin dhe mënyrën e dhënies së dekoratave vendos Këshilli Drejtues i Odës, ndërkaq i dorëzon Kryetari i Odës ose personi i autorizuar prej tij.
3. Nëse i dekoruari nuk pranon ta merr Dekoratën atëherë veprohet sikurse Dekorata të mos ishte dhënë fare.
4. Vendimi për dhënien e dekoratave publikohet në Web-faqen zyrtare të Odës.
5. Vendimi për dhënien dhe revokimin e dekoratave publikohet në buletinet e Odës dhe përfshihet në një Libër të veçantë të dekoratave e cila mbahet në arkivin e Odës.

Neni 14
Dhënia e Dekoratës pas vdekjes

1. Dhënia e Dekoratës pas vdekjes së të dekoruarit i bëhet familjarëve të tij: bashkëshortit/tes, fëmijët, të adoptuarit, nipat/mbesat, prindërit, adoptuesit, vëllezërit dhe motrat e të dekoruarit.
2. Nëse i dekoruari nuk ka anëtar të familjes sipas paragrafit 1. të këtij neni dhënia e Dekoratës publikohet në ueb-faqen zyrtare të Odës dhe ruhet si një pasuri e Odës.

Neni 15
Revokimi i dekoratës

1. Të dekoruarit, mund ti revokohet Dekorata nëse vepron në kundërshtim me Kodin Etik të Odës, moralin dhe kryen vepra tjera që e bëjnë të pa denjë për bartjen e Dekoratës.
2. Propozimin për revokimin e dekoratës mund ta bëjë propozuesi për dekoratë, Komisioni apo Kryetari i Odës.
3. Kryetar i Odës me aprovim të Këshillit Drejtues nxjerrë vendim për revokimin e dekoratës anëtarit të Odës.
4. Vendimi për revokimin e Dekoratës publikohet në ueb faqen zyrtare të Odës.

III. KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN E DEKORATAVE

Neni 16
Përbërja e Komisionit vlerësues

1. Komisioni vlerësues përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Odës që emërohen nga Këshilli Drejtues i Odës me propozim të Kryetarit të Odës, ku njëri prej tyre zgjedhet Kryetar i komisionit.
2. Mandati i Komisionit përcaktohet nga organi i cili e ka emëruar, përkatësisht Këshilli Drejtues i Odës.
3. Nëse kryetari i Komisionit ose një anëtar i Komisionit mungon pa arsye më shumë se tre herë në takimet e Komisionit ose nuk i përmbush detyrat e veta në punën e Komisionit, Kryetari i Odës mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të Odës shkarkimin e tij dhe emërimin e një anëtarit të ri.

4. Detyrat administrative për nevojat e Komisionit ofrohet nga Shërbimit Profesional i Odës.
5. Asistenca juridike e Komisionit i ofrohet nga Zyrtari Ligjor i Shërbimit Profesional të Odës.

Fushëveprimi i Komisionit
Neni 17

1. Komisioni mbledh dhe shqyrton propozimet për dhënien apo revokimin e dekoratave dhe çmimeve vjetore dhe përgatit propozimin përfundimtar.
2. Këshilli Drejtues i Odës përcakton punën e Komisionit Vlerësues për Dekorata dhe Çmimet vjetore me një akt të veçantë.


DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE


Neni 18
Hyrja në fuqi

1. Ndryshmet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje behën sipas të njëjtës procedurë së miratimit.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Odës.

Prishtinë,
06.04.2022

Kryetari i OSK-së
Prof. Dr. Blerim Kamberi





Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafi 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 12/11/2022, nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. Për ndryshimin e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Rregullores për dhënjën e dekoratave në OSK me nr prot 2321 të datës 12.04.2022 dhe fshihet fjalia “ së paku 1”.
- II. Pas ndryshimit nën paragrafi 1.1 do të ketë këtë përmbajtje: Anëtarit të Odës i cili ka publikuar punimin e vet origjinal shkencor, në revistat shkencore me faktorin e indeksuar të ndikimit (*Impact factor*) në bazën e të dhënve *Web of Science* apo *Scopus*.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi me date 01.01.2023.

I'dërgohet:

- Shërbimit Profesional

Prishtinë, 12.11.2022

Kryetari i OSK-së
Prof.Dr.Blerim Kamberi

